



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

DATE/A:	26.01.2026
REFERENC-Ë:	417 /IKMN/2026
PËR/ZA/TO:	Kadri Rahimaj, Kryetar i komunës së Kamenicës
CC:	Afrim Berisha, u.d, Kryeshef Ekzekutiv i AMMK-së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Fadil Bajraktari, Drejtor i IKMN-së
NGA/OD/FROM:	Nexhmije Kamberi, Zyrtare për Biodiversitet
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Nxjerrja e vendimeve për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, në Kamenicë

I nderuar z. Rahimaj,

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233, Neni 19, paragrafi 3 dhe në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Neni 17, Asambleja Komunale e Kamenicës duhet të shqyrtoj raportin e studimeve të vlerave të trashëgimisë natyrore në territorin e komunës së Kamenicës dhe të merr vendim për mbrojtje e objekteve të propozuara.

Gjatë vitit 2023, zyrtarët e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në bashkëpunimin me zyrtarët komunal, përmes vizitave në terren kanë evidentuar gjithsejtë njëzetë e pesë (25-të) objekte të trashëgimisë natyrore në komunën e Kamenicës.

Pastaj, për trembëdhjetë (13-të) objekte që i plotësojnë kriteret për mbrojtje (Tabela 1) Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, ka hartuar bazën profesionale për vënien nën mbrojtje ligjore të vlerave të trashëgimisë natyrore në komunën Kamenicës dhe i propozon Kuvendit Komunal të kësaj komune të nxjerr vendimet për mbrojtjen ligjore të tyre.

Tabela 1. Objektet e trashëgimisë natyrore në komunën e Kamenicës

Emërtimi		Vendi/ lokacioni	Kategoria e propozuar për mbrojtje
1	Guri i Busavatës	Ruboc	Kategoria III MN më karakter gjeomorfologjik
2	Ahu (<i>Fagus sylvatica</i>)	Gjyrishec	Kategoria III MN me karakter botanik)
3	Kompleks i Ahut (<i>Fagus sylvatica</i>)	Tugjec	Kategoria III MN me karakter botanik)
4	Ahut (<i>Fagus sylvatica</i>) me burimin e ujit nën rrënjë	Tugjec	Kategoria III MN me karakter botanik)
5	Ahu (<i>Fagus sylvatica</i>)	Zajqec	Kategoria III MN me karakter botanik)

Bashkangjitur e gjeni materialin profesional (Raportin, Elaboratet dhe Vendimet) në formën fizike dhe digjitale (CD-e) për trashëgimin natyrore - Monumentet Natyrore të propozuara, në territorin e komunës së Kamenicës.

Me respekt!